



*Kolegji
"Universum" Prishtinë,
Ferizaj*

KOLEGJI
"UNIVERSUM"

**RREGULLOREN MBI
PROCEDUREN DHE MASAT
DISIPLINORE**

Në bazë të nenit 22, pika 7 e Ligjit mbi arsimin e lartë në Kosovë, nenit 36, pika 7, si dhe neni 139 i Statutit të Kolegjit Universum, Këshilli Drejtues shpall:

RREGULLOREN MBI PROCEDUREN DHE MASAT DISIPLINORE

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet identifikimi i shkeljes së procedurës disiplinore, shkeljet disiplinore, emërtimi i komisionit disiplinor, mbështetja e komisionit disiplinor dhe çështjet e tjera në pajtim me ligjin dhe Statutin e Kolegjit Universum.

Neni 1

Rektorati i Kolegjit Universum për shkeljet serioze të supozuara e formon Komisionin Disiplinor.

Neni 2

Komisioni përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm;

1. Drejtori i departamentit ose divizionit – kryetar i komisionit;
2. Një përfaqësues e stafit akademik – anëtarë i komisionit;
3. Një përfaqësues sipas natyrës së shkeljes;

Neni 3

Mandati i anëtareve të komisionit disiplinor zgjatë aq sa zgjatë mandati i organit i cili i ka emëruar.

Neni 4

Në raste e konfliktit të interesave të ndonjë anëtari të komisioni, si dhe kur vihet në dyshim objektiviteti i veprimeve, kërkohet zëvendësimi i anëtarit për çështjen në fjalë.

Neni 5

Zëvendësimi i anëtarit të komisionit është i detyrueshëm në këto raste:

1. Kur anëtari i komisionit është i përfshirë në çështje;
2. Kur anëtari i komisionit është në gjini gjaku;
3. Bashkëshorti/ja e personit të përfshirë në çështjen disiplinore;
4. Rastet e tjera të cilat ndikojnë në objektivitetin e vendimmarrjes.

Neni 6

Departamentet, divizionet dhe shërbimi i Kolegjit “Universum”, ka për obligim që komisionit disiplinor t’i ofroj:

1. Këshilla dhe udhëzime për anëtarët e komisionit;
2. Grumbullimin e dëshmimeve të dokumentuara;
3. Përcaktimin e datës dhe orës së mbajtjeve të seancave;
4. Njoftimi i personave me lejen paraprake të komisionit për detajet e vendtakimit, datës dhe orës;
5. Mbajtjen e procesverbalit dhe vendosjen në dosjen e personave të involvuar në çështjen disiplinore.

Neni 7

Seancat e komisionit disiplinor duhet të mbahen në kohën e parë të mundur, por jomë vonë se 14 ditë.

Vendimi duhet të merret jo më larg se 60 ditë prej ditës së njoftimit me rastin.

Neni 8

Komisioni disiplinor gjatë vërtetimit të gjendjes faktike, ka të drejtë:

1. Të vërtetoj faktet e paraqitura;
2. Të marr në pyetje dëshmitarë;
3. Të përcaktoj se a ekziston thyerja disiplinore;

Neni 9

Komisioni pas shqyrtimit të hollësishëm të çështjes, propozon masën disiplinore organit kompetent (Rektorit, Drejtoreve të Departamenteve ose Drejtorëve të Divizioneve).

Neni 10

Vendimi i komisionit i dorëzohet palëve të involvuara në procesin disiplinor brenda 3 dite.

Neni 11

Vendimi i komisionit, si dhe deklarata vendosen në dosjen e shkelësit të rregullave brenda Kolegjit Universum.

Neni 12

Shkeljet e supozuara ose ato të bazuara në fakte duhet të paraqiten tek udhëheqësi i njësisë organizative brenda Kolegjit Universum.

Neni 13

Udhëheqësi i njësisë përkatëse, pas lajmërimit të rastit, obligohet që në afatin prej 48 orësh të paraqet rastin para komisionit disiplinor.

Neni 14

Komisioni disiplinor pas pranimit të rastit interviston palët e involvuara, analizon deklaratat, vlerëson faktet, si dhe i propozon udhëheqësit të njësisë masën disiplinore të natyrës Culpa Levis ose Culpa lata (shkelje e lehtë ose shkelje e rëndë).

Neni 15

Vendimin mbi masën disiplinore e merr udhëheqësi i njësisë në përputhje me këtë Rregullore.

Shkeljet disiplinore

Neni 16

Në kuadër të Culpa Levi (shkeljet e lehta) disiplinore hyjnë:

1. Mungesat e paarsyeshme në punë;
2. Gabimet e vogla nga pakujdesia;
3. Gabimet e recedivuara nga pakujdesia;

Neni 17

Komisioni disiplinor gjatë vërtetimit të shkeljes disiplinore ka për detyrë:

1. Mbledh dhe shqyrton çdo dokument dhe evidencë në lidhje me rastin;
2. Marrjen në pyetje personat e involvuar;
3. Personat të cilit kanë informacione.

Neni 18

Intervistimet duhet të zhvillohet në momentin e parë të mundshëm, por jo më larg se tri ditë nga dita e paraqitjes së rastit.

Neni 19

Komisioni disiplinor në rastet kur vijnë në përfundim se shkelja është e lehtë, shqipton masën disiplinore **paralajmërim verbal**.

Shkeljet e lehta të përsëritura sanksionon **paralajmërimi me shkrim**.

Procesverbali i paralajmërimit me shkrim dhe me gojë, vendoset në dosjen e personave të involvuar në shkeljen disiplinore.

Neni 20

Në rastet kur supozohet se është kryer shkelje e rëndë disiplinore, Komisioni disiplinor, interviston palët e involvuara brenda 5 ditësh nga dita e lajmërimit të rastit.

Neni 21

Shkeljet e rënda konsiderohen:

1. Kundërshtimi i paarsyeshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës;
2. Vjedhja mashtrimi, falsifikimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë;
3. Thyrja e rendit shtëpiak;

4. Mungesa nga puna pesë ditë radhazi pa arsye dhe pa lajmërim të mungesës;
5. Gabimet e përsëritura të cilat me recidivizmin dhe peshën e tyre çrregullojnë ecurinë normale të punës;
6. Diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, kundër personit tjetër në Kolegjit Universum, në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, religjionit, banimit, bindjes politike, gjendjes sociale, si dhe rastet e tjera të mbrojtura me ligj.
7. Abuzime për qëllime të ultë morale, shkelja e dinjitetit të personit në punë që është e padëshirueshme ose fyese e cila krijon armiqësi, duke kërcënuar ose frikësuar atë person;
8. Sjellja e papranueshme jashtë vendit të punë që nuk përkon me rregulloret e personelit ose studentit në Kolegjit Universum, si dhe e cila mund të diskreditojë;
9. Dëmit i pronës me paramendim;
10. Mos ruajtja e sekreteve zyrtare e profesionale;
11. Paaftësia serioze gjatë punë e shkaktuar nga alkooli ose droga;
12. Dhënia e deklaratave të paautorizuara dhe të pavërteta;
13. Sjellja agresive, kërcënuese ose fyese në vendin e punës, si shkeljet e tjera të cilat janë në kundërshtim me të drejtën pozitive.

Neni 22

Komisioni disiplinor pas shqyrtimit të hollësishme të rastit i propozon organit përkatës që të aplikojnë këto masa;

1. Vërejtje me shkrim;
2. Vërejtje e fundit;
3. Ndalimi i pagesës nga 10% deri në 15%;
4. Ndalimi i rritjes së pagesës deri në një vit;
5. Mos ngritja e pozitës deri në tre vite;
6. Ulja në pozitë, si dhe
7. Ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Masat e parapara në pikën një dhe dy, shqiptohen nga Udhëheqësit e njësisë kompetent, ndërsa masat disiplinore nga pika tre deri në shtatë i propozon komisioni disiplinor, ndërsa i shqipton Rektori.

Neni 23

Personi i pakënaqur me vendimin e Komisionit disiplinor për masat disiplinor, ka të drejtë e ankesës në shkallë të dytë:

1. Për shkeljet e lehta, shkalla e dytë është Rektori,
2. Për shkelje të rëndë shkalla e dytë është Bordi drejtues.

Personat të cilit janë të pakënaqur me vendimin e organeve kompetente në shkallë të dytë ka të drejtën e vazhimit të procedurës së jashtë institucionit sipas dispozitave ligjore pozitive.

Neni 24

Bordi Drejtues ose Rektori (në tekstin e mëtejme organi kompetent) emëron një komision të anketave.

Neni 25

Komisioni përbëhet nga tre anëtarë përhershëm nga radhët e anëtareve të organit kompetent.

Neni 26

Mandati i anëtareve të komisionit përputhet me mandatin e organit i cili emëron. Anëtarët e komisionit të ankesave nuk mund të jenë edhe anëtarë të komisionit disiplinor.

Neni 27

Anëtarët e komisionit të ankesave zëvendësohen në këto raste:

1. Në rastet e lidhjes familjare;
2. Raport varësie epror punëtor;
3. Është i involvuar në objektin disiplinor.

Neni 28

Paraqitësi i ankesës duhet të paraqesë argumente dhe fakte të reja, duke përmbledhur shkurtimisht arsyen për ankesë.

Neni 29

Seanca për shqyrtimin e ankesës duhet të mbahet jo më larg se 30 ditë nga dita e paraqitjes së ankesës.

Neni 30

Komisioni i ankesave ka për detyrë:

1. Të rishqyrtoj dëshmitë
2. Të përcaktoj se ankesa a pranohet;
3. Të përcaktoj masën disiplinore të përmirësuar që duhet të zbatohet, por jo më të lartë se masa e propozuar në shkallë të parë.

Komisioni mund të kërkoj prezencën e dëshmitarëve për të dëshmuar rastin.

Neni 31

Qëllimi i komisionit të ankesave është që të marrë parasysh dëshminë në ankesë, duke marr dëshmi plotësuese në gjetjen e fakteve të bazuara.

Neni 32

Seanca e dëgjimit duhet të kompletohet në momentin e parë të mundur, por jo më larg se 15 ditë prej ditës kur rasti është paraqitur.

Neni 33

Komisioni vendos me shumicë të kualifikuar.

Organi përkatës në bazë të propozimit të Komisionit merr vendim i cili i kumtohet ankuesit brenda 5 ditëve nga dita e marrjes.

Procesverbali i komisionit të ankesave duhet të vendoset në dosjen e ankuesit.

Neni 34

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregullore bëhet sipas procedurës së miratimit, por me kërkesë:

1. Të Rektorit;
2. Kryetarit të Bordit Drejtues;
3. Një të tretës së anëtarëve të Këshillit Akademik.

Neni 35

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Bordit Drejtues.

Prishtinë, nëntor 2009

Kryetari i Bordit Drejtues
Z.Suat Berisha
